



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:089348
Datë: 07.10.2024
Numri i dokumentit: 06261448

C.nr.624/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Florid Hasku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit K. (K.) me seli në Prishtinë, Distrikti në Gjakovë, kundër të paditurit Sh. (N.) Rr., nga Gjakova, Rr. . . , me objekt të çështjes kompensim i dëmit material, vlera e kontestit 379.21 euro, pas mbajtjes të shqyrtimit kryesor publik, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit dhe të paditurit, me datë 20.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit K. (K.) dhe DETYROHET i padituri Sh. (N.) Rr., nga Gjakova, që paditëses në emër të dëmit material të shkaktuar t'ia paguajë shumën prej 379.21 euro, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke e llogaritur nga data 07.05.2021 (datë e paraqitjes të padisë) e deri në pagesën definitive, këtë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, nën detyrimin e përmbarimit ligjor.
- II. DETYROHET i padituri, që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 20.00 €, në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën detyrimin e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi K. (K.) Distrikti në Gjakovë, me datë 07.05.2021, ka parashtruar padi kundër të paditurit Sh. (N.) Rr., nga Gjakova, Rr. . . . , me nr. 2, me objekt kontesti kompensim i dëmit material, me vlerë të kontestit prej 379.21 euro.

I. Pretendimet të palëve

Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë në vlerë prej 379.21 euro, dëmi i shkaktuar nga i padituri si pasojë e veprës penale, vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 par 6 lidhur me par 1 të KPRK-së. I padituri me aktgjykimin P.nr.710/2019 të datës 18.09.2020 i cili ka marrë formën e prerë me datë 12.10.2020 të nxjerrë nga Gjykata Themelore në Gjakovë është shpallur fajtor për veprën penale të kryer. Lartësia e dëmit vërtetohet në bazë ta faturës së kalkulimit nga sektori i rikthimit të humbjeve përkatësisht faturës me numër 247536, datës 22.05.2019, ku shihet se llogaritja e dëmit është bërë në bazë të pajisjeve elektrike të cilat kanë qenë në momentin e

kryerje së keqpërdorimit. Llogaritja e dëmit dhe mjetet monetare është bërë në bazë të faturës me numër DGJ-HP198497 e datës 24.05.2019, e cila faturë është në pajtueshmëri me rregulloren për procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike e miratuar nga ZRE, më saktësisht neni 14 ku të paditurit nga momenti i konstatimit të keqpërdorimit të energjisë elektrike i është llogaritur në mënyrë retroaktive për 6 muaj e që rezulton të jetë edhe vlera e kërkesëpadsisë. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas shqyrtimit të administrimit të provave të cekura më lartë u konstatua dhe u vërtetua se i padituri, paditëses i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 379.21 €. Andaj propozojmë Gjykatës që padinë dhe kërkesë padinë të aprovoi në tërësi si të bazuar, e po ashtu të obligoi të paditurin në shpenzimet e taksës gjyqësore për padi në vlerë prej 20,00 €.

I padituri ne përgjigje në padi në shqyrtimin gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se unë nuk kam qenë në Kosovë që nga viti 2012 në muajin gusht e deri më 2020 në muajin dhjetor, por kur kanë qenë kontrolla nuk e di çfarë date aty nuk ishte askush, por ata dy persona që kanë qenë kanë dashtë me hy nga djali i axhës apo nga kulmi ku kanë dalur në oborr dhe e kanë takuar djalin e vëllaut dhe i kanë marrë çelësat poshtë dhe kanë hipur naltë në katin e dytë ku banoj unë. Me ç' rast ata e kanë lajmëruar bashkëshorten time e cila nuk ishte aty dhe ka ardhur dhe i ka takuar në hyrje të shtëpisë me ç' rast i ka pyetur kush jeni ju dhe ka thënë që ta thërrasim policinë, dhe e ka thirrur policinë. Kur ka ardhë policia ata persona nuk ishin më aty, për të cilin gruaja e ka paraqit rastin në KEK, ka ardh personi i Kekut e ka heq prej njehsorit të babës dhe e ka vendosur në shtyllë. Gjithashtu gjykatës do t'ia sjell edhe dëshmitë se në periudhën e sipër cekur nuk kam qenë në Kosovë. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se unë prej vitit 2012 e deri në dhjetor 2020, nuk kam qenë në Kosovë edhe këta si e marrin për bazë me i dënua pa qenë në Kosovë, pa qenë në shtëpi. Dmth këta e marrin 6 muajshin pa qenë në shtëpi si dhe fakti tjetër se unë ka qenë i lidhur në njehsorin e babës. Kur janë të lidhur gjysma e popullatës në një shtëpi dhe vijnë tek unë dhe më bëjnë një dënim që 6 muaj ditë me paguar atë dënim, pa qenë në shtëpi fare. Nuk e di çfarë ligji ka të këta kur këta e dënojnë me pare pa qenë kurrkush në shtëpi. Unë nuk kam asnjë cent borxh këtyre me ju pagua, ndërsa pagesën e çdo fature të re jam duke e paguar atë prej janar 2021.

2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare lidhur me këtë çështjen juridike kontestimore, gjykata ka administruar provat si në vijim: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, me nr. të lëndës P.nr.710/19, të datës 18.09.2020, i plotfuqishëm me datë 12.10.2020; Njoftimi i datës 15.02.2021, i lëshuar nga Departamenti ligjor-zyra ligjore K.; Kalkulimi i RH të datës 22.05.2019, ID e rastit 247536, të lëshuar nga Departamenti për Konsumator – K.; Fatura me nr. DGJHP 198497 të datës 22.05.2019 të lëshuar nga KES/CO; Kartela e veteranit të lëshuar për Sh. Rr.n, me numër të dosjes 06094, nga OVL, me date 01.11.2017 si dhe Dëgjimi i dëshmitares D. N. Rr., nga Gjakova.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra, në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar

çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi si e bazuar.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Nga leximi i Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, me nr. të lëndës P.nr.710/19, të datës 18.09.2020, i plotfuqishëm me datë 12.10.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri është shpallur fajtor për veprën penale Vjedhja e shërbimeve Komunale, nga neni 314 paragrafi 6. lidhur me par.1 të KPRK-së, ku me veprimin të kundërligjshëm këtu palës paditëse i ka shkaktuar dëm material, ndërsa pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike. Në rastin konkret konstatimet në aktgjykimin e lartcekur penal, përveç përgjegjësisë penale të paditurit, janë esenciale edhe sa i përket dëmit të shkaktuar nga kryerja e veprës penale, ku sipas këtij aktgjykimi i padituri si kryes i veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni nga neni 314 paragrafi 6. lidhur me par.1 të KPRK-së, i ka shkaktuar dëm të dëmtuarës, këtu paditëses, në shumë prej 379.21 Euro.

Nga leximi i njoftimit të datës 15.02.2021, i lëshuar nga Departamenti Ligjor - zyra ligjore K., gjykata vërtetoi faktin se paditësi e ka njoftuar të paditurin lidhur me keqpërdorimin e energjisë elektrike si dhe e ka ftuar të paditurin që në afat prej 7 ditësh të arrijnë marrëveshje për pagesën e dëmit të shkaktuar. Po ashtu, faktet që vërtetohen nga kjo provë, vërtetohen edhe me provat tjera, ashtu që kjo provë nuk është në kundërshtim me provat tjera të administruara.

Nga leximi i Kalkulimit i RH të datës 22.05.2019, ID e rastit 247536, të lëshuar nga Departamenti për konsumator-K. gjykata ka vërtetuar faktin se kalkulimi i energjisë së shfrytëzuar është bërë për periudhën kohore prej 6 muajsh dhe atë duke filluar nga muaji Prill 2019, duke i llogaritur shpenzimet e krijuara nga pajisjet elektronike të gjetura në shtëpinë e paditësit, sipas procesverbalit të datës 19.03.2019, me numër 2529552, ku në mënyrë të detajuar janë përshkruar të gjitha shpenzimet e energjisë elektrike për secilën pajisje elektronike shtëpiake.

Nga leximi i Faturës me nr. DGJHP 198497 të datës 22.05.2019 të lëshuar nga KES/CO, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri në periudhën kohore prej 6 muajsh, i ka shkaktuar dëm palës paditëse në shumën prej 379.21 euro, në atë mënyrë që i padituri e ka shfrytëzuar energjinë elektrike, e cila energji nuk është regjistruar.

Nga dëgjimi i dëshmitares D. Rr. e cila ka deklaruar se: *“Në ditën kur ka ndodhur rasti, unë kam qenë të vëllai ku kam banuar një kohë dhe me kanë thirr në telefon vajza e djalit të axhës burrit dhe me kanë thënë se kanë ardhur këta të K.-it dhe janë futur brenda në shtëpi pa qene askush.”* Me tej ka theksuar se *“Në moment unë jam ardh në shtëpi dhe i kam gjetur ata në oborr dhe në atë moment e kam thirrur policinë sepse nuk e kam njohur faktin se si ata kanë të drejtë të hyjnë në shtëpi pa qenë askush aty. Gjithashtu nuk e kam ditur se si i kanë pasur çelësat të kunati poshtë. E kam thirrur policinë, K.-i kanë shkuar nuk ka nejtur aty, policia ka ardhur në vendin e ngjarjes dhe i kam treguar se ishte ngjarja, sepse nuk e kam ditë se si i kanë marrur çelësat e shtëpisë. Policia lidhur me këtë e ka bere një deklaratë por përsëri me kanë thirrur në telefon*

për të pyetur përsëri lidhur me rastin dhe të cilëve ia kam shpjeguar përsëri sepse me arsyetim të tyre se letrat janë humbur. Një ditë tjetër më kanë thirrur të K.-it janë ardhë me e lidhë kabllon në shtylle për të kryer procedurën e tyre dhe me kanë thënë e nuk kanë çka për të thënë sepse lenden e kanë dërguar atje.”

4. Baza ligjore e kërkesëpadisë

Gjykata zbatoi dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077 (LMD), për të vendosur lidhur me këtë çështje, dhe atë në nenin 9 parashihet se “*Secili person ka për detyrë të përmbahet nga veprimi që mund t’i shkaktoj dëm tjetrit.*”, lidhur me nenin 136, paragrafi 1 i cili përcakton se “*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”. Ndërsa nenet 137 citohet: “*Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)*” dhe nenin 140 “*Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose pakujdesia*”.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret gjejnë zbatim edhe dispozita e nenit 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ku është përcaktuar se: “*Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor*”, kjo ngase aktgjykimin penal me të cilin është vërtetuar fajësia e të paditurës është i detyrueshëm për gjykatën për vërtetimin e përgjegjësisë penale, e këtu të paditurës dhe ekzistimit të veprës penale.

5. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Gjykata nga provat të administruara ka vërtetuar faktin se i padituri është shpallë fajtor me vendim të formës së prerë dhe se me veprimet e tij ka dëmtuar paditësen në shumën prej 379.21 euro, gjithashtu vlerësoi se paditësja ka argumentuar përgjegjësinë e të paditurit në shkaktimin e këtij dëmi, përmes aktgjykimit penal dhe nuk e konsideroi të nevojshme vërtetimin e përgjegjësisë së tillë edhe në procedurë civile, por e morri si fakt të provuar në procedurën tjetër, nga kjo rrjedh se për gjykatën është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë së paditëses, pasi që në këtë rast është vërtetuar përgjegjësia penale e të paditurit dhe ekzistimi i veprës penale.

Sa i përket lartësisë së kërkesës, gjykata të njëjtën e vërtetoi nga aktgjykimin penal, pastaj nga kalkulimi i rikthimit të humbjeve dhe faturës, këto provat të cekura si më lartë, me ç’rast gjeti se i padituri me veprimet e tij ka dëmtuar paditësin në shumën prej 379.21 euro.

Sa i përket pretendimit të paditurit nuk ka të ardhura të mjaftueshme për të përmbushur detyrimin, gjykata gjeti se ky pretendim nuk gjen vend në këtë aktgjykim, pasi në procedurë civile, gjykata është e kufizuar të trajtojë çështjen kontestimore sipas të drejtës subjektive të pretenduar të shkelur të palës, e që në këtë rast, edhe e vërtetoi se me veprimet e të paditurit, paditëses i është shkelur e drejta subjektive, konkretisht i është shkaktuar dëm në shumën e theksuar si më lartë,

dëm ky i shkaktuar nga i padituri, i cili me fajësinë e tij në shkaktimin e dëmit bart përgjegjësinë për kompensimin e këtij dëmi, andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërsa bazuar në neni 7 par. 1 i LPK-së, është paraparë se “*palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*”, andaj gjykata është e lidhur vetëm me propozimet dhe provat të cilat i propozojnë palët ndërgjyqës.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës të cilat janë administruar në shqyrtimin kryesor por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritorë të kësaj çështje juridike kontestimore, siç është edhe deklaratat e dëshmitares D. Rr., të cilën gjykata e vlerësoi se e njëjtat nuk është relevante dhe pa ndikim në vendosjen meritorë të kësaj çështje juridike.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në bazë të nenit 452, paragrafi 1 dhe 463, paragrafi 1 të LPK-së, pasi që paditësi e ka fituar kontestin, dhe i ka specifikuar shpenzimet e procedurës, për taksë gjyqësore shumë prej 20.00 euro (*e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore*).

Nga të theksuarat si më lartë dhe bazuar në nenin 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. 624/21, me datë 20.09.2024

Gj y q t a r i
Florid Hasku

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes të të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.